



**VENDIM**  
**Nr.103 Datë 10.12.2010**

**PËR**  
**FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR**  
**RINOVIMIN E LIÇENSËS SË SHOQËRISË “FAVINA 1” SH.P.K NË**  
**AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 pika 5 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a” dhe nenit 37 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Favina 1” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi rinovimin e liçensës në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “Favina 1” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për proçedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finciar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Çdo modifikim ose ndryshim i mundshëm i dokumentacionit të të dhënave teknike (neni 16, pika 1, gërma “d”)

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për rinovimin e liçensës së shoqërisë “Favina 1” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**

**Bujar NEPRAVISHTA**

